KUVENDI
NR 2512 DATE 02.10.'20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

Nr.____Prot. Tiranë më __________2020

**Lënda:** **Kërkesë për interpelancë me Ministren e Kulturës Eva Margariti**

**Drejtuar :** **z.Gramoz Ruçi**
**KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

Zoti Kryetar i Kuvendit !

Bazuar në nenin 80 pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në nenin 96 të Rregullores së Kuvendit, ju paraqes kërkesën për interpelancë me Ministren e Kulturës, për të diskutuar çështjet e mëposhtme :

A ka bërë Ministria e Kultures një rivleresim të veprave kulturore të realizmit socialist ?

Si i përcakton Qëndra Kulturore Kombëtare e Kinematogreafisë vlerat në filmat shqiptarë të paraviteve 90 dhe tani në vazhdimësi ? Dhe a janë ata filma në përputhje me Kushtetutën dhe të drejtat e njeriut ?

Si janë shmangur vlerat ideologjike dhe propaganda e diktaturës komuniste nga filmat e paraviteve 90, të cilat ato i kishin qëllim në vetvete ?

A ka një numër të Lapidarëve dhe përmendoreve të realizmit socialist dhe si i keni klasifikuar ?

A janë parqet dhe lulishtet e një vendi një mundësi për të përhapur kulturen dhe historinë e kombit ? Si i keni shfrytëzuar ju këto?

Veprat e Artit të Rilindjes Urbane sa na kanë kushtuar dhe a mund ti quajmë art që përhap culturë ?

Keni në çdo rreth varreza dëshmorësh të ekzagjeruara shpesh me varre fiktive. A mendoni se duhet një inventar i formatizuar për to ?

Kush është konceptimi juaj rreth figures së një dëshmori? A keni bërë ndonjë varrezë të dëshmorëve nacionalistë ?
A keni vizituar ju personalisht një varrezë apo varr dëshmori nacionalist?

Kishat, Xhamitë, Teqetë që i keni shpallur si muze,tek te cilat ju nuk investoni dot,pse nuk ia lini komuniteteve fetare për t'i rregulluar dhe administruar,të jenë pronë e tyre me statusin e muzeut ?

**Artur Roshi**

**DEPUTET**